



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 29.06.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-414

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel.+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 29.06.2023

Në mbështetje të nenit 23, paragrafi 1.10, duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 1, të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, duke vendosur në lidhje me zgjedhjen e prorektores për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore, sipas propozimit të rektorit me Nr. Prot. 01-392, të datës 27.06.2023, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

1. Prof. Ass. Dr. Adelina Rakaj, zgjedhet prorektore për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.
2. Mandati i prorektores së lartcekur është i lidhur me atë të Rektorit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e punës së prorektores të zgjedhur sipas këtij vendimi janë të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Kosovës, Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Obligohet e lartcekura që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë deklarin e pasurisë, në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-50 për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, si dhe deklarin pas largimit nga funksioni, brenda afatit tridhjetë (30) ditor, në pajtim me nenin 10 të këtij ligji.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- Zyrës së personelit;
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurës;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja  
Kryesues i Këshillit Drejtues